

Shtojca III. Përgjigja e Menaxhmentit të Komunës së Gjilanit ndaj të gjeturave të ZAP-it

Të gjeturat	Pajtohemi PO / JO	Komentet nga Institucioni i audituar në rast të mospajtimit	Pikëpamja e ZAP-it
<p>E gjetura 1: Shpalosjet në Pasqyrat Financiare</p>	PO		
<p>E gjetura 2: Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak</p>	JO	<p>Te pika 3. Rekomandimet e vitit paraprak mendojmë se: Rekomandime të adresuara janë 4 (sipas Shtojcës II nr.5, 6.3, 7.1, 7.2). Dallim nga vlerësimi i juaj është rekomandimi nr.7.1 ku ne mendojmë se është rekomandim i zbatuar me që menaxhmenti i komunës ka mbajtur takime të rregullta me Këshillin e Drejtorëve ku janë adresuar edhe detyrat konkrete për zbatimin e rekomandimeve duke filluar nga Kryetari i Komunës, drejtorët e drejtorive dhe menaxherët e tjerë.</p> <p>Të adresuara pjesërisht janë po ashtu 4 rekomandime: 6.1, 6.2.2, 6.2.4 dhe 6.4. Dallim nga vlerësimi i juaj është rekomandimi nr.6.1 me që në tremujorin e fundit të vitit 2012 janë nënshkruar të gjitha kontratat me shfrytëzuesit e pasurive komunale (dëshmi kopja e kontratave të testuara dhe një regjistër tjetër mbi angazhimet në këtë drejtim)</p> <p>Rekomandim i pa adresuar ende është rekomandimi nr.6.2.1.</p>	
<p>E gjetura 3: Raporti i vetëvlerësimit</p>	PO		

<p>E gjetura 4: Inkasimi jo i mirë i të hyrave vetjake</p>	<p>PO</p>	<p>E gjetura qëndron, por ky inkasim jo i mirë ka ndodhur për shkak se Ministria e Punëve të Brendshme ka bërë ndryshimin e kriterëve të inkasimit të të hyrave nga gjobat e trafikut. E kjo ka ndikuar në rënje të inkasimit për 260,693 €. Me kalimin e kohës menaxhmenti i komunës në vazhdimësi e bënë planifikimin e të hyrave konform statistikës reale të inkasimit nga vitet paraprake, ashtu që borxhet e viteve të më hershme vazhdimisht po ndikojnë në shkallën e ulët të inkasimit.</p>	
<p>E gjetura 5: Të hyrat nga qiraja</p>	<p>JO</p>	<p>Në tremujorin e fundit të vitit 2012 janë rishikuar të gjitha kontratat mbi qiradhënien dhe për disa raste është filluar procedura gjyqësore, për disa raste është bërë ripërtirja e kontratave dhe ka pasur edhe lidhje të kontratave të reja me shfrytëzues të rijë (dëshmi kopja e disa kontratave dhe një regjistër tjetër mbi lidhjen e kontratave të reja).</p>	
<p>E gjetura 6: Vonesa në depozitim të hyrave në bankë</p>	<p>PO</p>	<p>Pajtohem me të gjeturën, por ky tani është rast i izoluar dhe se QKMF-ja ka nxjerr Vendim mbi dorëzimin e menjëhershëm ditor të mjeteve të inkasuara (dëshmi Vendimi nr.04-115 datë 13.02.2013).</p>	
<p>E gjetura 7: Kontrata pa zotim të mjeteve</p>	<p>PO</p>		
<p>E gjetura 8: Devijimi nga PIP</p>	<p>PO</p>	<p>Kjo ka ndodhur për shkak se kemi qenë të detyruar të bëjmë shkurtimin e mjeteve kapitale për pagesat e shërbimeve kontraktuese në Drejtorinë e Arsimit.</p>	
<p>E gjetura 9: Vonesa në përfundimin e punëve</p>	<p>PO</p>		
<p>E gjetura 10: Kompensimi i organeve mbikëqyrëse</p>	<p>JO</p>	<p>Nga Prilli i vitit 2012 mbikëqyrja e projekteve bëhet nga kompania e kontraktuar për mbikëqyrje (dëshmi Kontrata nr.02-16-5079 datë 13/04/2011 dhe vazhdimi i kontratës nr.02-16-41545 datë 18/04/2012) Të gjeturat e AP kanë të bëjnë me kontratat të cilat janë nënshkruar para vitit 2011 dhe ende janë në proces.</p>	

<p>E gjetura 11: Subvencione dhe mallra nga Investimet Kapitale</p>	<p>PO</p>	<p>Pagesa për koshere të bletëve është paguar nga investimet kapitale sepse kemi llogaritur se është investim kapital, me që vlera e tyre është mbi 1000 € dhe afati i përdorimit të tyre është mbi një vit dhe përfitues janë qytetarët e komunës së Gjilanit. Kjo pagesë është kryer nga Projekti “ Projekte Zhvillimore për Bujqësi, Blegtori dhe Pylltari” që është i aprovuar me Ligjin mbi Buxhetin. Gjithashtu edhe pagesa e Fat.nr.01/2012 datë 22.10.2012 në shumë prej 20,000€ është bërë nga investimet kapitale sipas një Marrëveshje me Caritasin në Ferizaj për “Përkujdesje shëndetësore” ku janë blerë pajisje me vlerë kapitale me që pas një kohe të caktuar ato pajisje do ti mbesin në shërbim QKMF-së në Gjilan (neni 4 i Marrëveshjes me datë 08.10.2012). <i>Dëshmi një kopje e kësaj Marrëveshje</i></p>	
<p>E gjetura 12: Tejkalimi i kontratës për furnizim</p>	<p>PO</p>		
<p>E gjetura 13: Dreka zyrtare dhe servisim i automjeteve</p>	<p>PO</p>		
<p>E gjetura 14: Paga jashtë kontratës</p>	<p>Pjesërisht</p>	<p>Pajtohemi pjesërisht sepse pjesa e parë e të gjeturës që ka të bëjë me pagesën e një arsimtari me pagë të drejtorit nuk qëndron ashtu si është e cekur në Draft Raportin e AP. Arsimtari i përmendur faktikisht për ata tre muaj ka kryer njëkohësisht edhe detyrën e drejtorit dhe se ai është paguar vetëm me pagë të drejtorit (<i>dëshmi opinionit i Drejtorisë së Arsimit, kopja e listave të pagave për muajt shtator , tetor, nëntor /2012) dhe kopja e Kontratës nr.05-892/2012, datë 26/11/2012 së Drejtorit të ri që dëshmon se deri në atë ditë i njëjti ka punuar edhe si drejtor edhe arsimtar.</i></p>	
<p>E gjetura 15: Shkelje e Rregullores</p>	<p>PO</p>	<p>Rregullorja për subvencionim është respektuar te personat fizik dhe juridik prej Momentit të aprovimit të saj, me përjashtim të subvencionimeve te Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ku me kohë në momentin e aprovimit të</p>	

		buxhetit janë paraparë aktivitetet të cilat duhet të subvencionohen: Teatri i Qytetit, Klubet sportive, Shoqëritë Kulturore Artistike etj. Andaj edhe subvencionimi është bërë në bazueshmëri të planifikimeve buxhetore të aprovuara nga Kuvendi Komunal. Pra përcaktimi i subvencioneve është bërë nga vetë Drejtoritë Komunale, kurse Kryetari i Komunës vetëm ka bërë aprovimin e tyre.	
E gjetura 16: Mungesë e marrëveshjeve dhe raportimeve	PO	Kryesisht subvencionimi i individëve është bërë në bazueshmëri të sukseseve të deritashme, apo edhe për shkak të ndonjë nevoje materiale për ndonjë varfëri të skajshme. Andaj përkundër insistimeve tona për raportime të mëvonshme për arsyetimin e subvencioneve ka pasur raste kur ata (përfituesit) nuk e kanë bërë atë.	
E gjetura 17: Konflikt interesi	PO	Subvencionimi i është ndarë Organizatës Studentore “Unioni i Studentëve Pro Evropjan”, e jo individit.	
E gjetura 18: Regjistrimi i pasurive në SIMFK	PO		

Sa i përket rekomandimeve të dhëna, pajtohem me të gjitha rekomandimet me që mendojmë se janë të qarta dhe të mirëseardhura për një menaxhim më të mirë, por kërkojmë që komentet e tona të merren parasysh dhe Raporti ta ketë një pasqyrim sa më real dhe korrekt për publikun.

Paraprakisht ju falënderojmë për punën dhe angazhimin e bërë, duke u zotuar gjithnjë për bashkëpunim të mirë.

Me respekt : Qemajl Mustafa –Kryetar i Komunës së Gjilanit
